

**RELACION**  
**PËR**  
**“PROJEKTVENDIMIN**  
**“PËR**  
**KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRFITIMIT TË**  
**POSEDUESVE TË NDËRTIMEVE PA LEJE NË RASTET E**  
**FATKEQËSISË NATYRORE”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Projektakti përbën një nismë për konceptimin e kuadrit nënligjor në zbatim të nenit 30, të ligjit nr.20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe konkretisht normat që rregullojnë kriteret dhe procedurat e përfitimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që dëmtohen nga fatkeqësitë natyrore.

Në këtë kuptim, qëllimi parësor i këtij projektakti, është përcaktimi në mënyrë të plotë i kriterëve dhe procedurave që do të aplikohen dhe do të ndiqen në rastet e poseduesve të ndërtimeve pa leje, të cilat kanë pësuar dëmtime nga fatkeqësitë natyrore.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektvendimi është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve për vitin 2022 dhe vjen si nevojë e plotësimit të kuadrit nënligjor, në zbatim të ligjit nr.20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Në këndvështrim të programit politik të Këshillit të Ministrave, projektvendimi i përgjigjet vizionit për një formë të drejtë të trajtimit të subjekteve, posedues të ndërtimeve pa leje, të cilët mund të pësojnë dëmtime nga fatkeqësitë natyrore, sipas nenit 30, të ligjit nr.20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

**III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Miratimi i këtij projektakti paraqet rëndësi të veçantë, pasi nëpërmjet tij përcaktohen rregulla për trajtimin e poseduesve të ndërtimeve pa leje në raste

fatkeqësish natyrore. Kjo realizohet nëpërmjet përcaktimit të saktë e të plotë të kushteve, kriterëve e procedurave përkatëse, që do të ndiqen në rastet e trajtimit të kërkesave të poseduesve të ndërtimeve pa leje, që kanë pësuar dëmtime në rastet e fatkeqësive natyrore. Kjo është risi e ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, pasi në ligjin e mëparshëm nr.9482, datë 3.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” (aktualisht i shfuqizuar), nuk ishte parashikuar rregullimi i këtyre rasteve.

Nëpërmjet miratimit të këtij projektakti, do t’i jepet zgjidhje në të ardhmen rasteve të trajtimit të subjekteve posedues të ndërtimeve pa leje që pësojnë dëmtime në rastet e fatkeqësive natyrore, duke siguruar mbrojtje ligjore për këtë kategori, sipas parashikimeve të legjislacionit për strehimin social ose nga programet e rindërtimit të parashikura në legjislacionin për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore. Në kushtet kur, është miratuar më parë legjislacioni i përgjithshëm për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore (akti normativ nr.9, datë 16.12.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore” dhe akteve të dala në zbatim të tij, i cili ka parashikuar në mënyrë të përgjithshme rregullat që do të zbatohen për këto raste, për të mos krijuar përsëritje, u pa e nevojshme që në këtë projektvendim të parashikohet vetëm ajo pjesë që nuk gjen trajtim tek legjislacioni i përgjithshëm, dhe konkretisht ajo ka të bëjë me kriteret dhe procedurat që lidhen me rastet e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që kanë pësuar dëmtime në rastet e fatkeqësive natyrore.

Në përfundim, efektet e pritshme të projektaktit lidhen pikërisht me mundësinë për trajtimin e kategorisë së këtyre subjekteve, sipas legjislacionit për strehimin social, ose nga programet e rindërtimit të parashikura në legjislacionin për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore, duke u mundësuar realizimin e të drejtave civile që lidhen me strehimin.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektvendimi është në përputhje me Kushtetutën, Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, legjislacionin për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore dhe ligjin nr.20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Baza ligjore për nxjerrjen e vendimit të propozuar gjendet tek neni 30, i ligjit nr.20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, i cili në paragrafin 1, përcakton ndër të tjera se: “ ... Kushtet,

*kriteret ane procedurat e perjitimit perkaktonen me vendim te Keshillit te Ministrave”.*

Nga shqyrtimi i projektaktit rezulton se permbajtja e tij nuk tejkalon kompetencen qe i eshte akorduar Keshillit te Ministrave nga dispozita e mesiperme ligjore.

Për sa i përket çështjes së kushtetutshmërisë së projektvendimit, nga pikëpamja formale, ai përbën një akt nënligjor të nxjerrë në respektim të tre kriterëve të parashikuara nga neni 118 i Kushtetutës:

*1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë.*

Përveç çështjes së bazueshmërisë ligjore, të shtjelluar më sipër, vendimi i propozuar do të nxirret nga Këshilli i Ministrave - organ kushtetues.

*2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.*

Miratimi i këtij projektakti është qartësisht në respektim edhe të këtyre kriterëve, pasi të gjitha përcaktimet e dispozitës kushtetuese të mesiperme, lidhur me autorizimin për nxjerrjen e aktit, organin kompetent dhe përmbajtjen, gjejnë pasqyrim në ligj.

*3. Organi i autorizuar me ligj për të nxjerrë akte nënligjore, siç specifikohet në paragrafin 2 të këtij neni, nuk mund t'ia delegojë kompetencën e tij një organi tjetër.*

Argumentimin e pajtueshmërisë me këtë parashikim e gjykojmë të panevojshëm, duke qenë se vetë nisma për propozimin e aktit ndaj Keshillit të Ministrave, është në vetvete tregues i saj (pajtueshmërisë).

Në këndvështrim të nenit 116 të Kushtetutës, i cili përcakton aktet normative me fuqi juridike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe hierarkinë e tyre, vendimi i propozuar është evidente se i përket kategorisë së “akteve normative të Keshillit të Ministrave”, të parashikuara në pikën 1 ç) të nenit. Si i tillë, bazuar në argumentimin e parashtruar më sipër, vlerësojmë se projektvendimi i përmbahet kufijve të përgjithshëm të vendosur nga normat/aktet më të larta, si dhe respekton përmbajtjen e tyre.

Në lidhje me kushtetutshmërinë në këndvështrimin lëndor/thelbësor, vlerësojmë se, projektakti u përmbahet standardeve kushtetuese.

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Projektvendimi nuk transponon ndonjë akt të veçantë të *acquis* së BE-së.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Nga pikëpamja strukturore (tekniko-legjislative), projektvendimi është i ndarë në dy krerë të cilët përmbajnë përkatësisht:

- I. Objektin dhe përcaktimin e terminologjisë së përdorur në projektakt, përkufizimin e subjekteve përfitues.
- II. Kushtet, kriteret dhe procedurat e trajtimit të ndërtimeve pa leje në rastet e fatkeqësisë natyrore.

Në kreun I, pika 1 parashikohet objekti i këtij projektakti.

Pika 2 e projektaktit përkufizon kuptimin e termave “ligji”, “përfitues”, “ndërtim pa leje”, “organ përgjegjës/njësi zbatuese”.

Në kreun II, pika 1 e projektaktit përcaktohen kriteret dhe kushtet që duhet të plotësohen nga ndërtimi pa leje ose nga individi/familja për të përfituar nga trajtimi sipas këtij projektvendimi, në rastet e fatkeqësisë natyrore. Këto kritere/kushte janë parashikuar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe legjislacionit të përgjithshëm për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore (akti normativ nr.9, datë 16.12.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” dhe akteve të dala në zbatim të tij.) Pika 2, parashikon organin i cili inicion procedurën e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që dëmtohen nga fatkeqësia natyrore.

Pika 3, parashikon procedurat që kryen ASHK dhe afatin brenda së cilës kryen këto procedura.

Pika 4, parashikon njoftimin dhe dokumentacionin që shoqëron vendimin e përjashtimit nga legalizimit që i përcillet organit përgjegjës/njësisë zbatuese dhe subjektit, posedues të ndërtimit pa leje.

Pika 5, duke përdorur si analogji gjendjen e fatkeqësisë natyrore të ndodhur në nëntor të vitit 2019, parashikon faktin se kriteret dhe kushtet e përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore të subjekteve përfitues sipas këtij projektvendimi, janë në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave për kushtet dhe kriteret e përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim miratuar në zbatim të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave natyrore të fatkeqësisë natyrore”.

Pika 6, parashikon institucionet përgjegjëse që ngarkohen me zbatimin e parashikimeve të këtij akti dhe momentin e hyrjes në fuqi të tij.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Institucionet e ngarkuara për zbatimin e këtij projektakti, janë njësitë e vetëqeverisjes vendore, organet publike që preken nga ky vendim dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

## **VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektvendimi është hartuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektvendimi, duke qenë i lidhur me ngjarje të së ardhmes, të cilat nuk dihet se kur do të ndodhin, ka ndikim në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit, por ndikimi duhet të llogaritet rast pas rasti nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe autoritetet shtetërore përgjegjëse sipas rasteve të parashikura në këtë projektvendim.

**PROPOZUESI**

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**